

## **Pozita: Auditor i Brendshëm**

*Rreth nesh:*

Moneta është institucion financiar jobankar (IFJB), kompani lidere në Kosovë me seli në Prishtinë, e specializuar në ofrimin e shërbimeve financiare. E licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës dhe MoneyGram International, Moneta ofron shërbimet e transferit të parave, shërbimin e pagesave nëpërmjet rrjetit të saj të agjentëve anembanë Kosovës.

*Rreth pozitës:*

Jeni gati për të nisur një udhëtim sfidues dhe domethënës në MONETA?

Ne jemi në kërkim të një kolegu/eje të përkushtuar, profesional dhe të motivuar për t'u bashkuar me ekipin tonë në Departamentin e Auditimit të Brendshëm. Auditori i Brendshëm do të ketë për detyrë të kontribuojë në përmirësimin e sistemeve të menaxhimit financiar, ligjor, të performancës dhe të kontrollit të brendshëm brenda Moneta SHPK, në përputhje me standardet profesionale dhe praktikat më të mira të auditimit.

### **Përgjegjësitë kryesore:**

- Zbaton auditime sipas planit vjetor të miratuar të auditimit të brendshëm;
- Propozon fusha të rëndësishme për auditim bazuar në analiza të rrezikut për planifikim strategjik dhe vjetor;
- Harton programe të auditimit dhe pyetësorë për vlerësimin e funksionimit të kontrolleve të brendshme;
- Aplikon gjykim profesional dhe analiza të sakta për të nxjerrë konkluzione dhe rekomandime të bazuara në dëshmi;
- Përgatit letra të punës të strukturuar;
- Ruajtja dhe mirëmbajtja e dokumentacionit të auditimit në përputhje me standardet profesionale;
- Ndihmon në përdorimin e teknikave të auditimit dhe teknologjisë përkatëse, si dhe mbështet Udhëheqësin e Auditimit sipas nevojës;
- Bën vlerësimin dhe monitorimin e rrezikut organizativ;
- Përcjell zbatimin e rekomandimeve të auditimit;
- Raporton në mënyrë të rregullt të mbikëqyrësi për progresin e auditimeve në zhvillim;
- Kryen detyra të tjera sipas nevojës dhe kërkesave të mbikëqyrësit.

### **Kualifikimet dhe aftësitë e kërkuara:**

- Diplomë universitare në Ekonomi, Financa, Kontabilitet ose fusha të ngjashme;
- Së paku dy (2) vite përvojë pune në auditim;
- Njohuri të mira të standardeve profesionale të auditimit, si dhe të kornizës ligjore dhe rregullative;



- Preferohen certifikime relevante profesionale: Auditor i Brendshëm i Certifikuar, auditor i sektorit publik, kontabilist i certifikuar ose teknik i kontabilitetit në SCAAK. Kandidatët pa certifikim duhet të jenë të gatshëm të vazhdojnë / nisin procesin e certifikimit përkatës;
- Aftësi të shkëlqyera analitike dhe për identifikimin e problemeve dhe dhënien e zgjidhjeve të bazuara në dëshmi audituese;
- Vëmendje në detaje dhe integritet profesional;
- Njohuri nga fusha e qeverisjes financiare dhe korporative;
- Aftësi të mira në përdorimin e MS Office dhe softuerëve të kontabilitetit;
- Aftësi të mira komunikuese në gjuhën shqipe dhe angleze; njohja e gjuhës serbe është përparësi.

Lokacioni: Prishtinë

Kandidatët e interesuar mund të aplikojnë duke dërguar CV-në e tyre në [audit.recruiting@monetaks.com](mailto:audit.recruiting@monetaks.com) Luteni që te vendosni titullin e pozitës në të cilën aplikoni, “Auditor i Brendshëm”.

Afati i fundit për aplikim: 20.05.2025

Për informata shtesë kandidatët mund të n’u kontaktojnë në email-in zyrtar [audit.recruiting@monetaks.com](mailto:audit.recruiting@monetaks.com).

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

